

shkollë nga shkaku i largësis së mashe të shtëpive të tyre, adoptoj sistemin e "MESUESIT SHETITES". Ky mik atëhere vinte në katunt më katunt edhe mësonte fëmijët për një kohë të shkurtër. Me këtë mënyrë të gjithë kishin rastin për të mësuar shkrim e këndim, dhe ca më tepër si të përmirësonin gjendjen e tyre. S' munt dim edhe ne të formojnë grupe Mësuesish Shetitës të cilët të mësojnë djalërinë që pret për dritë pa durim?

Ja ca fraza që dëgjonja në këtë vënt të ngratë: "Kam frykë se mos më mbesin fëmija pat shkollë!", më tha një nënë në Spaç. "Mermë në shkollë në Tiranë!", thoshte një djalosh; "Çomë në shkollë syn' e vetëm!", fliste një burr' i mocmë, dhe populli zbraste fjaltë, "Nuk kena shkollat!"

Eshtë fatmirësi se populli malësor ke zënë të ndjejë se koha e pushkës kaloj edhe se shpëtimí i tyre do vijë nga shkollat. Kjo është një shënj' e mirë dhe duhet të enkurajojë q' do përparimdashës, me gjithë që shumë pak punë është bërë në këtë vënt.

T' i japim funt kësaj pike, thom se fratërit me ndërgjegje kombëtare edhe Mësuesit Shetitës do t'ishin ata që do çduknin cipën e erësirës në këtë vënt plot hejje për diteni. Tre, katër, ose pesë Internata do mos zgjithnin Problemin Arësimtar të Mirditës.

---